

VENDIM
Nr. 77, datë 22.12.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese			
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“	
Sokol Berberi	anëtar i	“	“	
Vitore Tusha	anëtare e	“	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“	
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“	
Fatos Lulo	anëtar i	“	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“	

me sekretare Edmira Babaj, në datën 1.10.2015 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 49 Akti, që i përket:

KËRKUES: Azis Jata

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Financave, Departamenti i Administratës Publike

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 3060, datë 6.11.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; nr. 8, datë 2.2.2011 i Gjykatës së Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gani Dizdari, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesut, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi ka punuar si drejtor i Drejtorisë së Auditimit, Mbikëqyrjes dhe Investigimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Auditimit. Me aktin administrativ nr. 148/1, datë 27.1.2010 të DAP-it është liruar nga shërbimi civil me pretendimin se i janë dhënë dy vlerësime negative të njëpasnjëshme. Këto vlerësime janë kryer për periudhën nga 1.11.2007 deri 31.10.2008 dhe periudhën nga 1.11.2008 deri 31.10.2009 dhe në të dyja rastet është vlerësuar negativisht (jo mjaftueshëm).

2. Mbi bazën e ankimit të kërkesut, Komisioni i Shërbimit Civil, me vendimin nr. 31, datë 11.3.2010, ka vendosur: *“Pranimin e ankesës duke shfuqizuar aktin administrativ të vlerësimit të punës për vitin 2008 dhe 2009, pasi është subjektiv dhe në kundërshtim me procedurën e kërkuar nga ligji.”*.

3. Ministria e Financave ka bërë ankim kundër këtij vendimi në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. 54, datë 2.7.2010, ka vendosur: *“Shfuqizimin e vendimit të KSHC-së nr. 31, datë 11.3.2010 si të pambështetur në prova.”*.

4. Kërkuesi, pas daljes së aktit të largimit nga shërbimi civil, i mbështetur në vlerësimet negative të punës, i është drejtuar KSHC-së për shfuqizimin e aktit nr. 148/1, datë 27.1.2010 të DAP-it si absolutisht të pavlefshëm. KSHC-ja, me vendimin nr. 68, datë 21.4.2010, ka vendosur: *“Shfuqizimin e aktit nr. 148/1, datë 27.1.2010 të DAP-it si absolutisht të pavlefshëm, si dhe detyrimin e Ministrisë së Financave të kthejë në punë ankuesin dhe të bëjë pagimin e pagës për ankuesin që nga ndërprerja e marrëdhënieve financiare deri në kthimin në detyrë.”*.

5. Ky vendim është kundërshtuar nga Ministria e Financave dhe DAP-i, me ankime të veçanta, para Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. 8, datë 2.2.2011, ka vendosur: “*Pranimin e ankimit. Shfuqizimin e vendimit nr. 68, datë 21.4.2010 të KSHC-së.*” Po kjo gjykatë, me vendimin nr. 13, datë 8.2.2011 ka vendosur: “*Lënien në fuqi të vendimit nr. 68, datë 21.4.2010 të KSHC-së.*”

6. Kundër vendimit nr. 8, datë 2.2.2011 të Gjykatës së Apelit kërkuesi ka ushtruar rekurs dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-3060, datë 6.11.2014, ka vendosur: “*Mospranimin e rekursit.*”

II

7. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës, duke pretenduar se ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor. Sipas kërkuesit është cenuar:

7.1 Siguria juridike nga ana e Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila duke ndryshuar ndërgjyqësinë, ka ndarë ankimin e DAP-it për t’u shqyrtuar më vete nga ankimi i Ministrisë së Financave. Si rrjedhojë, jemi para dy vendimeve të Gjykatës së Apelit, që bien ndesh me njëri-tjetrin, pasi njëri ka rrëzuar ankimin e DAP-it, duke lënë në fuqi vendimin nr. 68, datë 21.4.2010 të KSHC-së (vendimi nr. 13, datë 8.2.2011), ndërsa tjetri ka rrëzuar ankimin e kërkuesit, duke shfuqizuar vendimin nr. 68, datë 21.4.2010 të KSHC-së (vendimi nr. 8, datë 2.2.2011).

7.2 Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi Gjykata e Lartë nuk i ka marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në rekurs, megjithëse ato kishin të bënin me shkelje kushtetuese. Gjykata e Lartë vetëm ka shtuar formalisht shkaqet e rekursit në vendim, pa u dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese, konkretisht pretendimit në lidhje me cenimin e sigurisë juridike nga ana e Gjykatës së Apelit Tiranë në dhënien e dy vendimeve të ndryshme për të njëjtën çështje. Kolegji Administrativ duhej ta kishte kaluar çështjen në gjykim, pasi u paraqitën shkelje të rënda procedurale. Ai nuk ka arsyetuar mjaftueshëm mungesën e shkaqeve të rekursit.

8. **Subjekti i interesuar, DAP-i**, ka paraqitur dy parashtrime, i pari mban datën 13.7.2015 dhe sipas tij, DAP bashkohet me pretendimin e kërkuesit për cenim të parimit të sigurisë juridike nga dhënia e dy vendimeve për të njëjtën çështje nga Gjykata e Apelit. Në parashtrimet e mëvonshme, të datës 18.9.2015, DAP-i mban qëndrim të ndryshëm, duke argumentuar se kërkuesi nuk legjitimohet në kërkimet e tij, pasi nuk ka shteruar mjetet juridike, duke qenë se vendimi nr. 13, datë 8.2.2011 nuk është ende përfundimtar, por në proces gjyqësor. Gjithashtu, sipas parashtrimeve të fundit të DAP-it, zgjidhja e konfliktit midis dy vendimeve të gjykatave nuk është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese, por në kompetencë të Gjykatës së Lartë, e cila në këtë rast është shprehur qartë për mospranimin e rekursit mbi këtë pretendim.

9. **Subjekti i interesuar, Ministria e Financave**, në parashtrimet e saj mban qëndrimin se:

9.1 Kërkuesi nuk legjitimohet, pasi kërkesa është paraqitur tej afatit 2-vjeçar nga dalja e vendimit nr. 8, datë 2.2.2011.

9.2 Ndërgjyqësia është formuar si duhet nga Gjykata e Apelit, pasi Ministria e Financave duhej të ishte e paditur, duke qenë se detyrimi financiar i kërkuar nga kërkuesi duhej të paguhej nga Ministria e Financave.

9.3 Ligjshmëria e vendimit nr. 13, datë 8.2.2011 është vendosur sërish nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me vendimin nr. 7399, datë 26.6.2014, ka vendosur: “Shpalljen të pavlefshëm të titullit ekzekutiv vendim nr. 13, datë 8.2.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë.”. Dalja e një vendimi të mëvonshëm nuk e cenon ligjshmërinë e vendimit nr. 8, datë 2.2.2011.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

10. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/f dhe

134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga ligji. Në kuptim të nenit 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, individit, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij, mund ta paraqesë kërkesën në Gjykatën Kushtetuese brenda 2 vjetëve nga data e njoftimit të vendimit të fundit të organit përkatës shtetëror. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se vendimi më i fundit në kohë është vendimi nr. 00-2014-3060, datë 6.11.2014 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

11. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata rithekson se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Ajo ndërhyr në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve dhe të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet 42 dhe 131, shkronja “P”, të Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimet nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 16, datë 19.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata vëren se argumentet e kërkuarit në mbështetje të pretendimeve për parregullsi të gjykimit në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe në Gjykatën e Lartë lidhen me respektimin e parimit të sigurisë juridike dhe standardin kushtetues të arsytimit të vendimit gjyqësor. Në këto kushte, nisur nga natyra *prima facie* e këtyre pretendimeve, Gjykata çmon se vlerësimi i tyre përfshihet në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike

13. Kërkuari ka pretenduar se është cenuar siguria juridike, pasi Gjykata e Apelit ka dhënë dy vendime që bien ndesh me njëri-tjetrin: i pari, vendimi nr. 8, datë 2.2.2011, ka vendosur pranimin e ankimit të Ministrisë së Financave dhe shfuqizimin e vendimit nr. 68, datë 21.4.2010 të KSHC-së, ndërsa i dyti, vendimi nr. 13, datë 8.2.2011, ka rrëzuar ankimin e DAP-it, duke lënë në fuqi vendimin nr. 68, datë 21.4.2010 të KSHC-së. Sipas kërkuarit, është cenuar siguria juridike nga vendimet gjyqësore, pasi aktualisht nuk është e qartë se cili vendim është i detyrueshëm për zbatim. Sipas tij, kjo shkelje nuk është shqyrtuar dhe as nuk është riparuar nga Kolegji Administrativ, si gjykatë më e lartë.

14. Gjykata ka theksuar se siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës. Parimi i shtetit të së drejtës ku mbështetet një shtet demokratik, nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike. Parimi i sigurisë juridike përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin te sistemi juridik (*shih vendimet nr. 25, datë 28.4.2014; nr. 20, datë 11.7.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht edhe nga kjo Gjykatë, e cila ka theksuar se “... *ligji procedural civil ka sanksionuar edhe parimin e gjësë së gjykuar (res judicata), parim i cili pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike...në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që, në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim.*” (*shih vendimin nr. 23, datë 8.6.2007; nr. 12, datë 17.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila ka nënvizuar se parimi në bazë të të cilit një vendim përfundimtar i formës së prerë është gjë e gjykuar

dhe zgjidh mosmarrëveshjen midis palëve me një efekt përfundimtar, është një element themelor i gjykimin të drejtë, që garantohet nga neni 6 i Konventës në çështjet civile. Parimi i sigurisë juridike dikton që kur një mosmarrëveshje civile është shqyrtuar në themel nga gjykata, vendimi i saj nuk vihet më në diskutim (*shih çështjen Kehaya dhe të tjerë kundër Bullgarisë, datë 12.1.2006*).

17. Gjykata, duke iu referuar çështjes konkrete, konstaton se vendimi i parë nr. 8, datë 2.2.2011 i Gjykatës së Apelit Tiranë ka zgjidhur konfliktin midis dy palëve të ndryshme nga ato të vendimit të dytë nr. 13, datë 8.2.2011 të po asaj gjykate, pavarësisht se në të dyja rastet e gjykuara efektet e këtyre vendimeve lidhen me largimin nga puna të kërkuarit. Ndryshe nga sa pretendon kërkuari, formimi i ndërgjyqësisë në rastin e parë është bërë sipas rregullave procedurale civile, pasi Ministria e Financave ka qenë që në fillim palë e paditur dhe jo person i tretë, dhe si e tillë, ajo duhej të ishte e paditur edhe në gjykimin në apel. Vendimi i dytë, pra nr. 13, datë 8.2.2011 i Gjykatës së Apelit, ka marrë një drejtim tjetër tashmë, referuar parashtrimeve të subjektit të interesuar, DAP-it. Me vendimin nr. 7399, datë 26.6.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ai është pezulluar së ekzekutuari, duke e shpallur të pavlefshëm titullin ekzekutiv, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë. Pra, të dyja vendimet e Gjykatës së Apelit kanë pasur palë të ndryshme dhe objekte të ndryshme gjykimi, prandaj ato nuk hedhin poshtë njëra-tjetrën dhe si të tilla nuk krijojnë situata të ndryshme juridike, ndryshe nga sa pretendon kërkuari. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se dhënia e dy vendimeve nga Gjykata e Apelit, pavarësisht se lidhen të dyja me kërkuarin, nuk krijon pasoja të tilla që e vendosin atë (kërkuarin) në një situatë të pasigurt nga pikëpamja juridike.

18. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuarit për cenimin e sigurisë juridike nga vendimet gjyqësore, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, janë të pambështetura.

C. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor

19. Kërkuari ka pretenduar se është cenuar standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor, sepse Gjykata e Lartë nuk i ka marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në rekurs, megjithëse ato kishin të bënin me shkelje kushtetuese. Kërkuari pretendon se vendimi i Kolegjit Administrativ nuk përmbush standardet kushtetuese të arsytimit të një vendimi gjyqësor. Sipas tij, ai Kolegj nuk ka arsyetuar mjaftueshëm mungesën e shkaqeve të rekursit. Madje arsyetimi është jologjik, pasi në të Kolegji është shprehur se rekursi i palës së paditur, DAP-it, nuk është i bazuar, ndërkohë që rekursi është paraqitur nga kërkuari. Gjykata e Lartë vetëm ka shtuar formalisht shkaqet e rekursit në vendim pa u dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese.

20. Gjykata rithekson se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës, si dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 55, datë 18.12.2012; nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykata kërkesën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar e ka vlerësuar rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, arsyetimi i kufizuar i vendimit të marrë në dhomën e këshillimit nuk e cenon procesin e rregullt ligjor. Kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit, nga ana e kolegjeve të saj, gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit luan rolin e një filtri të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit është një veprimtari e

domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Sipas këtyre standardeve, kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, vendoset për mospranimin e kërkesës dhe ky lloj shqyrtimi paraparak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih vendimet nr. 34, datë 12.7.2013; nr. 108, datë 3.10.2012; nr. 17, datë 17.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese, si dhe vendimin nr. 143, datë 7.12.2011 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

23. Edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka theksuar se “detyrimi që ka gjykata vendase për të arsyetuar vendimet e saj, nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse. Masa e arsytimit të vendimit varet nga natyra e vendimit në fjalë [...] arsyetimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomë këshillimi, në mënyrë të nënkuptuar evidenton se aplikanti nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës. Gjykata vëren se kur një gjykatë e lartë refuzon të pranojë një çështje, për arsye se mungojnë shkaqet ligjore për ngritjen e çështjes, një arsyetim shumë i kufizuar mund të përmbushë kriterin e nenit 6 të Konventës” (*Marini kundër Shqipërisë, datë 18.12.2007, §105-106; Mishgjoni kundër Shqipërisë, datë 7.12.2010, § 51*).

24. Në rastin konkret, vendimi nr. 3060 datë 6.11.2014 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë e ka përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimit objekt shqyrtimi. Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, shqyrton rekursat për pretendime të shkeljes së ligjit material ose procedural, gjë që përbën funksionin kryesor të saj. Ajo analizon çështjen në drejtim të kontrollit të ligjëshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara. Në zbatim të parimit të subsidiaritetit, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Raporti ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e kësaj Gjykate i kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr. 52, datë 2.12.2013; nr. 36, datë 25.7.2013; nr. 58, datë 24.12.2012; nr. 19, datë 2.4.2012; nr. 32, datë 28.12.2009; nr. 4, datë 28.2.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Bazuar në sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuarit, në lidhje me cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, është i pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Sokol Berberi, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Gani Dizdari

MENDIM PAKICE

Nuk pajtohem me qëndrimin e shumicës për këto arsye:

A. Për pretendimin se është cenuar parimi i sigurisë juridike nga Gjykata e Apelit.

1. Kërkuesi pretendon se duke qenë se Gjykata e Apelit ka dhënë dy vendime, që bien ndesh me njëri-tjetrin: njëri ka rrëzuar ankimin e DAP-it, duke lënë në fuqi vendimin nr. 68, datë 21.4.2010 të KSHC-së (vendimi nr. 13, datë 8.2.2011), ndërsa tjetri ka rrëzuar ankimin e kërkuesit, duke shfuqizuar vendimin nr. 68, datë 21.4.2010 të KSHC-së (vendimi nr. 8, datë 2.2.2011), si rezultat është cenuar siguria juridike nga vendimet gjyqësore, në këto rrethana nuk është e qartë se cili vendim është i formës së prerë dhe si i tillë i detyrueshëm për zbatim. Sipas tij, kjo shkelje nuk është shqyrtuar dhe riparuar nga Kolegji Administrativ, si gjykatë më e lartë. Ndryshe nga shumica, mendojmë se ky pretendim i kërkuesit është i bazuar dhe duhet pranuar. Dhënia njëkohësisht e dy vendimeve të ndryshme për të njëjtin objekt nga e njëjta gjykatë: konkretisht një vendim i Gjykatës së Apelit lë në fuqi aktin administrativ të largimit nga puna dhe vendimi tjetër i po asaj gjykate e shfuqizon atë, bie ndesh me parimin e sigurisë juridike në vendimarrjen gjyqësore, duke e lënë kërkuesin në një situatë të paqartë juridike.

2. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht edhe nga Gjykata Kushtetuese, e cila ka theksuar se “...në harmoni me parimin e sigurisë juridike, ligji procedural civil ka sanksionuar edhe parimin e gjësë së gjykuar (res judicata), parim i cili pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Kur vendimi ka marrë formë të prerë, ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padë kundrejt të njëjtave palë” (shih vendimin nr. 23/2007; nr. 12/2014 të Gjykatës Kushtetuese).

3. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila ka nënvizuar se parimi në bazë të të cilit një vendim përfundimtar i formës së prerë është gjë e gjykuar dhe zgjidh mosmarrëveshjen midis palëve me një efekt përfundimtar, është një element themelor i gjykimit të drejtë, që garantohet nga neni 6 i Konventës në çështjet civile. Parimi i sigurisë juridike dikton që kur një mosmarrëveshje civile është shqyrtuar në themel nga gjykata, vendimi i saj nuk vihet më në diskutim (shih çështjen *Kehaya dhe të tjerë kundër Bullgarisë*, datë 12.1.2006).

4. Përveç sa më sipër, jemi të mendimit se edhe vendimi i Kolegjit Administrativ nuk ka kontribuar në eliminimin e kësaj shkeljeje, duke mos u ndaluar në shqyrtimin e këtij pretendimi nga ana e kërkuesit. Kjo shkelje duhet të ishte riparuar nga Kolegji Administrativ, si gjykata më e lartë. Ky është edhe qëllimi i të gjykuarit nga një gjykatë më e lartë. Duke iu referuar natyrës së gjykimit të kërkesave individuale, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se “...kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e kësaj Gjykate të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131, shkronja “J”, të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj. Për pasojë, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe në kontrollin e respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhet të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike, parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe parimit të disponibilitetit, të parashtruara në rekurs nga kërkueset (shih vendimet nr. 4/2006; nr. 19/2012; nr. 12/2014 të Gjykatës Kushtetuese).

5. Për sa më lart, mendojmë se dhënia e dy vendimeve të ndryshme për të njëjtën çështje nga Gjykata e Apelit dhe mosriparimi i kësaj shkeljeje nga Kolegji Administrativ kanë cenuar parimin e sigurisë juridike në vendimarrjen gjyqësore duke e lënë kërkuesin në një situatë juridike të paqartë, për më tepër me pasojë negative për të.

B. Për pretendimin e mosarsyetimit sipas standardeve të vendimit të Kolegjit Administrativ

6. Kërkuesi pretendon se vendimi i Kolegjit Administrativ nuk përmbush standardet kushtetuese të

arsyetimit të një vendimi gjyqësor. Sipas tij, ai Kolegji nuk ka arsyetuar mjaftueshëm mungesën e shkaqeve të rekursit. Madje arsyetimi është jologjik, pasi në të Kolegji është shprehur se rekursi i palës së paditur, DAP-it, nuk është i bazuar, ndërkohë që rekursi është paraqitur nga kërkuesi.

7. Jemi të mendimit se edhe ky pretendim i kërkuesit është i bazuar dhe duhej pranuar. Referuar standardeve të arsyetimit të një vendimi gjyqësor, ky i fundit në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetres. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 55/2012; nr. 20/2012; nr. 38/2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Megjithatë, Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes e duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Gjykata ka vënë në dukje se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar dhe nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 55/2012; nr. 29/2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Gjithashtu, pjesa urdhëruese e vendimit të gjykatës duhet të jetë rezultat i natyrshëm i përfundimeve të arritura në pjesën arsyetuese. Ajo është përmbledhje e këtyre përfundimeve dhe si e tillë, në asnjë rast, nuk mund të jetë në kundërshtim me to. Vendimi që përmban ose lejon kontradiktën logjike cenon rëndë dhënien e drejtësisë. Ai nuk mund të jetë i kuptueshëm dhe bindës dhe për pasojë nuk mund të zbatohet në praktikë. Në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se çdo vendim gjyqësor që marrin gjykatat e zakonshme, duke mos zbatuar parimin e procesit të rregullt ligjor lidhur me detyrimin për t'i arsyetuar ato, ka efekte negative për palët që kanë kërkuar drejtësi nga këto gjykata (*shih vendimin nr. 33/2005; nr. 58/2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Neni 310/1 i KPC-së parashikon se vendimi i gjykatës duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese, duke përcaktuar në paragrafët e tjerë elementet që duhet të përmenden në secilën prej këtyre pjesëve. Referuar çështjes në shqyrtim, rezulton se vendimi i Kolegjit Administrativ ka një nonsens në arsyetim, pasi në pjesën arsyetuese i referohet rekursit të bërë nga pala e paditur (DAP), ndërkohë që rekursi është bërë nga kërkuesi (shih paragrafin 11 të vendimit). Gjithashtu, në dispozitivin e vendimit Kolegji shprehet për rekursin e ushtruar nga kërkuesi, duke krijuar pështjellim për sa i takon rekursit të ushtruar. Kjo cenon standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese.

11. Në rastin në shqyrtim, vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk i përmban këto standarde. Ai është i paqartë, konfuz dhe nuk u jep përgjigje të gjitha pretendimeve me natyrë kushtetuese të kërkuesit.

12. Për sa më lart, Gjykata duhej të kishte pranuar kërkesën, duke vendosur shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe të vendimit të Kolegjit Administrativ, për shkak të cenimit të parimeve të sigurisë juridike dhe të arsyetimit të vendimit gjyqësor, sipas standardeve kushtetuese të përcaktuara nga kjo Gjykatë.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Gani Dizdari, Vladimir Kristo